553. Duhet të përgatisni 100 g pomadë prednizoloni 0.5%. Shkruani formulën, përgatitjen, papajtueshmëritë kimiko-fizike (nëse ka), shpjegimet teknologjike, vetitë, përdorimin, ruajtjen.

554. Duhet të përgatisni 100 g pomadë sulfatazoli 5%. Shkruani formulën, përgatitjen, papajtueshmëritë kimiko-fizike (nëse ka), shpjegimet teknologjike, vetitë, përdorimin, ruajtjen.

555. Duhet të përgatisni 100 g pomadë tetracikline 3%. Shkruani formulën, përgatitjen, papajtueshmëritë kimiko-fizike (nëse ka), shpjegimet teknologjike, vetitë, përdorimin, ruajtjen.

556. Si formulohet insulina në mënyrë që të kemi shpejtësi të ndryshme veprimi?

557. Çfarë dini për përdorimin e përmirësuesve të shijes në përgatesat farmaceutike dhe për faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e tyre?

558. Rendisni pyetjet për të cilat farmacisti është i detyruar të japë shpjegime ndaj pacientit.

559. Rendisni këshillat që duhet t'i jepni pacientit në rastin e administrimit të kolireve.

560. Çfarë janë tretësirat për perfuzion, shembuj, karakteristikat, administrimi?

561. Çfarë janë përgatesat parenterale për ushqim total, shembuj, karakteristikat, administrimi?

562. Jepet formulimi:

<i>Sulfat zinku</i>	<i>1 g</i>
<i>Acid borik</i>	<i>5 g</i>
<i>Ujë i distiluar q.b. a</i>	<i>500 ml</i>

S. Pika për sy

Bëjeni izotonike me NaCl.

Ekivalenti i NaCl te sulfatit te zinkut eshte 0,15

Ekivalenti i NaCl te acidit borik eshte 0,55

563. Jepet formulimi:

Klorhidrat efedrine 1,2 g

Klorbutanol 0,3 g

Dekstrozë q.b.

Ujë i distiluar q.b.a 60 ml

S. Spray për hundë

Bëjeni izotonike.

Ekivalentët e NaCl: Efedrina*HCl = 0,28; Klorbutanoli = 0,18; Dekstroza = 0,16.

564. Llogaritni ΔT e një tretësire izotonike të NaCl (PM=58.5 dhe $\alpha = 1,85$)?

565. Një përgatesë për injeksion përmban 0,5% diltiazem klorhidrat. Llogaritni sa mg bar gjenden në 25 ml përgatesë.

566. Sa gr permanganat kaliumi duhen përdorur për të përgatitur formulën e mëposhtme.

Rp Permanganat kaliumi 0.02% p/v

Ujë i distiluar deri në 250 ml

567. Farmacisti peshoi në një peshore të pa kalibruar një sasi pluhuri dhe pesha i doli 475 mg. Duke patur dyshim në saktësinë e matjes ai e peshoi sërish pluhurin në një peshore të kalibruar saktë dhe pesha i doli 445 mg. Llogaritni përqindjen e gabimit të bërë në peshimin e parë.

568. Farmacisti përdori një cilindër të shkallëzuar për të matur vëllimin e një tretësire të lëngët dhe i doli 30 ml. Duke patur dyshim në saktësinë e matjes ai përdori një burE të të shkallëzuar dhe vëllimi i saktë doli 32 ml. Llogaritni përqindjen e gabimit të bërë në matjen e parë.

569. Farmacisti duhet të peshojë 5 mg bar. Peshorja që ka në farmaci peshon me një gabim prej ± 6 mg. Ndërkohë farmacistit i lejohet një gabim $\pm 5\%$ të sasisë së peshuar. Si duhet të veprojë farmacisti duke përdorur metodën e hollimit dhe laktozën si lëndë holluese?

570. Farmacisti duhet të peshojë 15 mg bar. Peshorja që ka në farmaci peshon me një gabim prej ± 6.5 mg. Ndërkohë farmacistit i lejohet një gabim $\pm 5\%$ të sasisë së peshuar. Si duhet të veprojë farmacisti duke përdorur metodën e hollimit dhe laktozën si lëndë holluese?

571. Farmacisti duhet të peshojë 50 mg bar. Peshorja që ka në farmaci peshon me një gabim prej ± 4 mg. Ndërkohë farmacistit i lejohet një gabim $\pm 4\%$ të sasisë së peshuar. Si duhet të veprojë farmacisti duke përdorur metodën e hollimit dhe laktozën si lëndë holluese?

572. Jepet një shurup 150 ml që përmban 65% p/v sakarozë. Shurupi lihet hapur dhe avullon deri në 85% të vëllimit fillestar (dmth largohet 15%). Sa është përqendrimi i ri i sakarozës?

573. Keni 1800 g tretësirë të përqendruar të amoniakut në përqendrimin 28% p/p. Gjени se sa g tretësirë amoniaku 10% p/p mund të përgatisni.

574. Ju kërkohet të përgatisni 4 litra tretësirë të një bari me përqendrimin 0.05% p/v. Keni në farmaci një tretësirë të përqendruar 1:400 p/v të barit. Sa ml të tretësirës së përqendruar ju nevojiten?

575. Ju kërkohet të përgatisni formulimin e mëposhtëm:

Efedrinë sulfat 0.25%

Ujë trëndafili deri në 30 ml

S. Në hundë

Keni në farmaci një tretësirë të përqendruar 2% p/v të barit. Sa ml të tretësirës së përqendruar ju nevojiten?

576. Jepet formulimi i mëposhtëm përshkruar me metodën e divizionit për 40 kapsula:

Ekstrakt belladone 0.4 g

Efedrinë sulfat 0.64 g

Fenobarbital 0.8 g

Aspirinë 12 g

Llogaritni sasinë e secilës prej lëndëve për të përgatitur 16 kapsula.

577. Data e skadencës së një bari galenik është 21 ditë nga dita e përgatitjes nëse ruhet në 5 °C. Gjeni për afërsisht kohëzgjatjen e qëndrueshmërisë së barit, nëse ruhet në 35 °C.

578. Data e skadencës së një bari galenik është 2 vjet nga dita e përgatitjes nëse ruhet në 5 °C (në frigorifer). Gjeni për afërsisht kohëzgjatjen e qëndrueshmërisë së barit, nëse ruhet në 25 °C (në temperaturën e dhomës).

579. Data e skadencës së pezullisë së ampicilinës është së përgatitur “ex tempore” është 14 ditë sipas monografisë nëse ruhet në 5 °C (në frigorifer). Gjeni për afërsisht zvogëlimin e kohëzgjatjes së qëndrueshmërisë së barit, nëse harrohet 6 orë në 25 °C (në temperaturën e dhomës).

580. Për të verifikuar njohjen e formave farmaceutike dhe kryerjen e praktikës në farmaci duhet t’u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

a) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si tabletë e zakonshme më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

b) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si tabletë e veshur me film më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

c) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si tabletë me çlirim të përndryshuar më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

d) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si shurup i gatshëm më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

e) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si shurup që përgatitet “ex tempore” më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

f) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si kapsula me xhelatinë të fortë më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

g) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si kapsula me xhelatinë të butë më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

h) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si granulate më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

i) Cilat janë 5 specialitetet farmaceutike formuluar si pluhura më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

j) Cilat janë 10 specialitetet farmaceutike formuluar si kollire më të shitura në farmacinë ku keni bërë praktikën profesionale?

581. Një grup mjekësh novatorë përshkruajnë formula magjistrale me mjekime të personalizuar (kapsula prej xhelatine të fortë) për pacientë të caktuar. Nëse ju do të punonit

në një farmaci dhe do t'ju duhej të përgatisnit, cilat do të ishin pajisjet, mjetet dhe lëndët që duhet të blenit?

582. Gjatë praktikës në farmaci keni vënë re që nifedipina gjendet në farmaci me emra të ndryshëm tregëtare. Bazuar në listën e rimbursimit të barnave disa prej tyre janë: Nifedipine Profarma, Pronipin, Nifelat R, Coral, Amarkor, Adalat Oros, etj. Thoni formulimin për secilin, dallimet, etj.

583. Jepet formulimi i mëposhtëm përshkruar me metodën e dispensionit për 40 kapsula:

Enalapril 7.5 mg

Laktozë deri në 200 mg

S. 1 kapsulë në mëngjes

Keni në farmacinë tuaj tableta të zakonshme enalapriili 20 mg. Peshë e një tablete është 120 mg. Llogaritni numrin e tabletave dhe sasinë e laktozës që ju nevojitet për përgatitjen e mësipërme.

584. Jepet formulimi i mëposhtëm:

Estropipate 0.0125 %

Bazë krem deri në 60 g

Sig. Krem vaginal

Keni në farmacinë tuaj tableta të zakonshme me estropipate 0.75 mg. Llogaritni numrin e tabletave që ju nevojitet për përgatitjen e mësipërme.

585. Jepen formulimet e mëposhtme:

Rp/

Aminophenasoni

Phenacetini aa.....0.20

Coffeini.....0.05

M.f.pulvis D.t.d N=X

D.S 3 x në ditë nga një pluhur

Rp/

Extracti Belladonnae siçi ...0.30

Magnesii oxydi2.0

Natrii hydrogencaboatis.....5.0

M.f.pulvis Div.in.dos.aequal. N=X

DS.3 x në ditë nga një pluhur

Cila prej tyre është e përshkruar me metodën e divizionit dhe cila me metodën e dispensionit? Jepni shpjegimet përkatëse.

586. Ju kërkohet të përgatitni 200 ml shurup paracetamoli 2.5% me vehikul “*Sirupus simplex*”. Përshkruani formulën e shurupit të thjeshtë dhe sasinë e lëndëve që nevojiten.

587. Ju kërkohet të përgatitni 500 ml shurup paracetamoli 2 % me vehikul “*Sirupus simplex*”. Përshkruani formulën e shurupit të thjeshtë dhe sasinë e lëndëve që nevojiten.

588. Thoni parimet e përgjithshme në të cilat mbështetet praktika e mirë e përgatitjes së barnave në farmaci.

589. Përshkruani karakteristikat që duhet të ketë laboratorit galenik i një farmacie në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.

590. Përshkruani pajisjet dhe dokumentacionin që duhet të ketë laboratorin galenik i një farmacie në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.
591. Përshkruani kërkesat për lëndët e para që përdor farmacisti (përgjegjësi e tij) në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.
592. Përshkruani dokumentacionin për lëndët e para që përdor farmacisti (përgjegjësi e tij) në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.
593. Përshkruani dokumentacionin për përgatitjet që bën farmacisti (përgjegjësi e tij) në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.
594. Përshkruani kontrollin e cilësisë për përgatitjet që bën farmacisti (përgjegjësi e tij) në përputhje me praktikën e mirë të përgatitjes së barnave në farmaci.
595. Cilat janë papajtueshmëritë kimike me të cilat mund të ndeshet farmacisti në rastin e përgatesave galenike? Si duhet të vepron?
596. Ju vjen një recetë me një bar që duhet të administrohet endovenë. Në farmacinë tuaj keni të njëjtin bar por në kuti shkruhet që është për përdorim intramuskul. Si do të vepron? Nëse bari jepet shpjegoni arsyet. Nëse bari nuk jepet shpjegoni arsyet.
597. Cilat janë rregullat që duhen ndjekur dhe këshilluar pacientët në mënyrë që barnat të ruhen mirë gjatë periudhës së verës?
598. Çfarë njohurish teknologjike keni për tretësitën parenterale të manitolit?
599. Ju vjen një recetë me një bar për administrim oral në dozën 250 mg për njësi. Në farmacinë tuaj keni të njëjtin bar por në dozën 500 mg. Si do të vepron? Nëse bari jepet shpjegoni arsyet. Nëse bari nuk jepet shpjegoni arsyet.
600. A njihni ndonjë material që përdoret si sistem për administrimin e barnave dhe që ndikon në sasinë që arrin në gjak?
601. Cila është më e efikase tableta orale apo sulinguale? Sqaro.
602. Cili ka qenë laboratorin i parë që ka prodhuar produkte kozmetike në Shqipëri?
603. Nga pikëpamja ligjore si procedohet me prodhimin, tregtimin e produkteve kozmetike në Shqipëri?
604. Ç'janë produktet kozmetike?
605. Ç'është sistemi INCI?
606. Si raportohen përbërësit e një produkti kozmetik në etiketë?
607. Çfarë elementësh duhet të ketë në etiketë?
608. A kanë skadencë produktet kozmetike?
609. Ç'janë Parabenet? Rënditni efektet e tyre të dëmshme.
610. Cilat janë alternativat që mund të zgjedhë një farmacist në vend të parabeneve?
611. Rënditni format e ndryshme kozmetike që njihni bazuar në strukturën e tyre.
612. Jepni ndryshimet bar kundrejt një produkti *Kozmeceutik (Cosmeceutical)*
613. Çfarë nënkuptojmë në kozmetikë kur përmendim *zonën gri*?
614. Cila është shtresa më e jashtme e lëkurës dhe si është e ndërtuar?
615. Pse preferohet të përdoret një qumësht kozmetik për pastrimin e lëkurës sesa një sapun i zakonshëm?
616. Gjatë përgatitjes së një locioni kozmetik për mbylljen e poreve cilat rregulla duhen mbajtur parasysh?
617. Cili është roli i acidit borik në përgatesat kozmetike?
618. Çfarë dini për faktorin natyral hidratues?

619. Çfarë janë lëndët okluzive?
620. Çfarë janë lëndët lagështuese?
621. Cilat janë këshillat e farmacistit kur rekomandon një preparat hidratues?
622. Një pacient vjen në farmaci me ankesa për lëkurë të thatë. Çfarë duhet të bëjë farmacisti?
623. Çfarë kuptohet me lëkurë të thatë dhe cilët janë faktorët që e shkaktojnë atë?
624. Cili është përbërësi kryesor i një koldkremit?
625. Si duhet kuptuar plakja e lëkurës?
626. Cilat janë masat parandaluese të zhvillimit të rrudhave? Renditni disa lëndë funksionale kundër rrudhave.
627. Ç'janë njollat e lëkurës dhe na se krijohen ato?
628. Si mund të trajtohen njollat?
629. Përse përdoret acidi glikolik?
630. Si vepron hidrokinoni kundër njollave?
631. Cilat janë kategoritë e filtrave për mbrojtjen nga dielli?
632. Çfarë nënkupojnë termat SPF, ëater-resistant, ëater-proof dhe përse shërbejnë?
633. Një konsumator kërkon një produkt për mbrojtjen nga dielli. Si duhet të veprojë farmacisti?
634. Cilët janë faktorët që dëmtojnë flokët?
635. Si parandalohet apo trajtohet dobësimi e rënia e flokut?
636. Cilat janë problemet që hasen me thonjtë dhe si trajtohen?
637. Cili është dallimi ndërmjet këto dy tipeve recetash me pluhura:
- I)
- Rp: Natrii sulfas siçatum 2.0
Natrii phospas siçatum 4.0
Natrii hydrocarbonas 6.0
M.f.pulv D.t.d N.10
D.S
- II)
- Rp: Natrii sulfas siçatum 20.0
Natrii phospas siçatum 40.0
Natrii hydrocarbonas 60.0
M.f.pulv. Div in partes e quales N.10
D.S
638. Si përgatitet një recetë me pluhura kur në përbërje të saj ka më shumë se dy barna pluhur kur kanë sasi të ndryshme, peshë specifike të ndryshme dhe gjendje kristalore (fizike) të ndryshme.
- Çfarë kuptimi kanë këto shkurtime fjalësh (latine) që përdoren gjatë shkruarjes së një recete nga mjeku.
- a. aa, add, ad us ext (ad usum externum), ad.us.int (ad usum
b. internum), ad.us.propr.(ad usum proprium), Aq.destill.(aqua destillata), DS (da signa),
D.t.d.N°, (Dentur Da) tales doses Numero) M.D.S (Misce, Da, Signa), q.s.(quantum santis).
639. Sa gr acid salicilik duhen në përgatitjen e një pomade Ung. Acidi salicilici 5% 120.0?
640. Sa gr klurur natriumi duhen për të përgatitur një tretësirë izotonike (0.9%) 800ml?

641. Cili është tretësi kryesor në përgatitjen e një perfuzioni, po për përgatitjet për injeksion?
642. Çfarë janë pilulat, supostet, ovulat, pomadat, pastat, linimentet? Cilat janë rrugët e përdorimit (të marrjes) të tyre?
643. Si ndikon temperatura në ruajtjen e cilësisë së barit. Si monitorohet ajo në farmaci? Çfarë janë barnat termolabile? Përmend disa prej tyre si dhe mënyrën e ruajtjes.
644. Cilat janë format e ngurta dhe të lëngëta të barnave me përdorim oral? Ku ndryshojnë ato nga njëra tjetra? Shtjello.

Kapitulli IV

Kazuse

645. Kur jepni një medikament, si kujdeseni për sigurinë e tij?
646. Do të zëvendësonit dy substanca aktive brenda të njëjtit grup?
647. N.q.s. dy medikamente prej të njëjtit grup duket se kanë të njëjtin efekt, cilin do të këshillonit?
648. Kur do të këshilloje preparate rektale?
649. Çdo të këshillonit në një rast konstipacioni?
650. Çdo të këshillonit në një rast diarrije akute me dehidrim të lehtë në një fëmijë?
651. Në farmaci vjen një pacient rreth 50 vjeç dhe ankon për dhimbje fyti. Nuk ka shenja të përgjithshme, një skuqje e lehtë fyti, pa temperaturë. Si do veprime?
652. Në farmaci vjen një pacient rreth 40 vjeç që ankon nga dhimbja e fytit. Nuk ka ethe, ka një skuqje të lehtë të fytit dhe vuan nga diarreja kronike. Çdo të mendoje?
653. Në farmaci vjen një pacienti yt i rregullt me çrregullim bipolar, i cili merr preparate të litiumit. Është periudhë argjërimit dhe ti e di që është besimtar. Çdo të këshilloje?
654. Në farmaci vjen një burrë rreth 65 vjeç për të marrë mjekimin e tij për dy muajt e ardhshëm. Ai tregon që ndjehet shumë mirë e nuk ka ankesa. Në recetë përshkruhen: digoksinë 0,25 mg (60 tab), isosorbite dinitrat 5 mg (180 tab), cimetidinë 200 mg (120 tab), prednizolon 5 mg (120 tab) dhe amoksicilinë 500 mg (180 tab). Çdo të mendoje? A do të ndryshojë diçka në këtë përshkrim?
655. Pacienti mund të vijë tek ju me një ankesë, një kërkesë ose një pyetje. Si do e trajtoni?
656. Në farmaci vjen një burrë rreth 45 vjeç, i cili vuan nga pagjumësia 6 muajt e fundit. Ai do të marre recetën me diazepam 5mg, 60 tableta. Çdo të mendoje?
657. Në farmaci vjen pacientja juaj që ankon për lodhje të vazhdueshme, mbas lindjes së fëmijës së dytë. Si do e këshillonit?
658. Në farmaci vjen një femër 22 vjeçe, 2 muaj shtatzane, e cila ka një abscess të madh në krahun e djathtë e do operohet shpejt. Kërkon aspirinë për të lehtësuar dhimbjen. Si do veprime?
659. Pacientit një djali 4 vjeç, me kollë, ethe me 39.5°C dhe diagnozë pneumoni i është përshkruar tetraciklina në tableta. Mendoni që është përshkrimi i duhur?
660. Pacientja 50 vjeçe e cila vuan nga sëmundje reumatizmale kronike, trajtohet me medikamentin indometacinë 3 herë nga 50 mg në ditë plus një supostë 50 mg në darkë. Ajo ankon për dhimbje herët në mëngjes. Si do e këshillonit?

661. Pacienti 18 vjeç, ankon për kollë të thatë pas një ftohje. Vjen me recetë ku ka të përshkruar kodeinë 30 mg, 1 tabletë 3 herë në ditë, 60 tableta. Është e përshtatshme kohëzgjatja dhe sasia e mjekimit, sipas mendimit tuaj?
662. Djalë 45 vjeç, ka nevojë për profilaksi ndaj malaries për një udhëtim dy javor në Ganë (Afrikë). Rp: Mefloquine 250 mg, 1 tabletë në javë, jep 7 tableta; fillimi një javë përpara nisjes dhe vazhdon për 4 javë pas kthimit. Është e përshtatshme kohëzgjatja dhe sasia e mjekimit, sipas mendimit tuaj?
663. Një pacient që i nënshtrohet herë pas here dializës për shkak të humbjes së funksionit veshkor paraqitet në farmaci dhe referon se po përdor një kurë me gentamicinë. Mjeku që mbikqyr dializën i ka rekomanduar që të administrojë një dozë të gentamicinës menjëherë pas përfundimit të procedurës dialitike, por pacienti është skeptik. Çfarë i shpjegoni këtij pacienti?
664. Një pacient që vuan nga insuficienca hepatike paraqitet në farmaci dhe pyet se pse mjeku i tij i ka përshkruar një pjesë të barnave që përdor në doza më të ulëta se ato që përdorte përpara identifikimit të insuficiencës hepatike? Çfarë përgjigje dhe shpjegimi do ti jepnit në këtë rast?
665. Në farmacinë paraqitet bashkëshorti i një qytetareje me recetë e së shoqes. E shoqja ka bërë trombozë dhe veç barnave të tjera receta përmban dhe enoxaparin 0.6 ml. Çfarë informacioni duhet të merrni nga bashkëshorti i pacientes, për pacienten, si duhet vepruar në rast se pacientja ushqen fëmijën me qumësht gjiri?
666. Në farmaci një qytetar iu referon se ndjen dhimbje shtrënguese në kraharor dhe megjithëse ka marrë trinitrinë ato nuk janë qetësuar. Çfarë mendoni për këtë situatë? Çfarë do ti rekomandoni pacientit?
667. Një pacient drejtohet me recetë pranë jush dhe ndër barnat e tjera ka të përshkruar barin trinitrinë. Ai iu referon se këtë bar mjeku ia ka shënuar për herë të parë si terapi. Çfarë rekomandimesh do i jepni ju pacientit? Spjego.
668. Një pacient në moshë madhore drejtohet pranë jush me recetë ku ndër të tjera ka të përshkruar barin methronidazol, 500 mg përdorim oral. Çfarë informacioni do i jepni pacientit për të bërë kujdes gjatë përdorimit të tij? Pse?
669. Përse për një kategori të caktuar barnash farmacisti këshillon pacientin të mos shoqërojë marrjen e tyre me qumësht. Për cilat kategori të barnave bëhet fjalë dhe pse?
670. Një pacient pasi ka ekzekutuar një recetë në farmaci e cila përmbante amlodipinë e më pas e ka përdorur atë, vjen i shqetësuar tek ju dhe ankon se ka fryrje të këmbëve. Si e shpjegoni ju situatën dhe çfarë do i rekomandoni pacientit?
671. Një pacient drejtohet pranë jush dhe kërkon të marrë në farmaci një shurup për kollë të thatë. Pacienti trajtohet për HTA me barin enalapril 20 mg dozë ditore. Si do të veproni me të?
672. Një pacient referon se ka patur reaksion nga penicilina. Cilat barna nuk duhet të përdorë ai?
673. Një pacient i cili merr digoxinë iu drejtohet ju për të marrë informacion se në dietën ushqimore cilin frut duhet ta ketë me prioritet për të përdorur? Pse? Argumento.
674. Në farmaci një nënë drejtohet për të marrë për fëmijën e vet paracetamol pasi ai ka temperaturë dhe shurup aceticisteine. Çfarë duhet të dini ju? A do e plotësoni gjithmonë këtë kërkesë të shtruar nga prindi? Argumento.

675. Një pacient drejtohet pranë jush në farmaci dhe ankon për dhimbje veshi. Si do e menaxhoni këtë rast dhe çfarë rekomandimesh do i jepnit?
676. Një pacient drejtohet pranë jush dhe ankon se ka diarre. Si do të veproni ju?
677. Gjatë mjekimit me ciprofloksacinë, plaquemil çfarë do i rekomandoni pacientit lidhur me ekspozimin në diell? Pse?
678. Në farmacinë e spitalit ju keni një sasi të caktuar me manitol në trajtë serumesh. Është dimër. Ju vjen kërkesë nga pavjoni për të përdorur te një pacient serum me manitol. Në momentin që ju veproni për të përmbushur kërkesën vëreni se manitoli ka precipituar në trajtë kristalesh në flakonin e serumit. Si do veproni në këtë situatë? A do e përmbushni kërkesën e pavionit?
679. Mjeku i ka përshkruar në recetë pacientit tretësirë 3% të acidit borik – 1 l të saj për kompresa. Çfarë rekomandimi do i jepni pacientit për ta pregatitur tretësirën? Ku konsiston?
680. Një pacient që ka kryer ciklin e kimioterapisë drejtohet pranë farmacisë tuaj për të marrë barnat e përshkruara në recetë. Receta përmban tabletë ondasentron, omeprazol, deksametazon tabletë, augmentinë 625 mg. Si e arsyetoni përshkrimin e barnave në recetë?
681. Përse përdorimi i kortizonikëve gjatë trajtimeve rekomandohet të merret pjesën e parë të ditës? Si bëhet fillimi i trajtimit me to? Po përfundimi i mjekimit si realizohet?
682. Një pacient ka marrë te mjeku rheumatolog një recetë për trajtimin e dhimbjeve reumatizmale. Ai i ka përshkruar dhe omeprazol 20 mg për mbrojtjen e aparatit tretës. Si do ia rekomandoni ju përdorimin e tij? Pse?
683. Një pacient me rrufë dhe me temperaturë drejtohet pranë jush. Ai iu referon se është dita e parë që është në këtë gjendje. Çfarë do i rekomandoni lidhur me barnat që duhet të përdori, dietën ushqimore dhe qëndrimin në ambiente.
684. Në farmacinë tuaj vjen një qytetare e cila paraprakisht referon se ka shtuar shumë në peshë e për pasojë kërkon të marrë preparat për rënien në peshë. Gjendur para kësaj situatë çfarë do kërkonte të dini nga qytetarja për të kuptuar arsyet e shtimit në peshë. Si do veproni me këtë qytetare?
685. Në farmacinë tuaj vjen një qytetare e cila paraprakisht referon se ka rrënie të flokut e për pasojë kërkon të marrë preparat kundër rënies së flokut. Gjendur para kësaj situatë çfarë do kërkonte të dini nga qytetaria për të kuptuar arsyet e rrënies së flokëve. Si do veproni me këtë qytetare?
686. Përse një grua shtatëzan gjatë periudhës së shtatëzimit rekomandohet të marrë acid folik, multivitamina me ose pa mikroelementë dhe kalcium? Në cilat faza të shtatëzimit rekomandohen ato? A mund të marrë barna të tjerë kjo grua?
687. Një nënë e cila ka një fëmijë të vogël që e ushqen vetëm me gji, drejtohet në farmaci e shqetësuar pasi kishte vërejtur që gjatë defekimit të fëmijës së vogël konsistenca e feçes së bebit ishte e ujshme, por fëmija nuk kishte asnjë problem shëndetësor. Ndërkohë, nëna referon se vet ishte duke u trajtuar me augmentinë 625 mg, 3 herë në ditë. Çfarë do mendoni lidhur me shqetësimin që ngre nëna? Çfarë do i rekomandoni asaj?
688. Një qytetar drejtohet pranë farmacisë për të marrë barna simptomatikë për trajtimin e gjendjes virale që kishte. Gjithashtu, i kërkon farmacinë të japi për të bërë një vaksinë anti virale. Çfarë rekomandimesh duhet ti japi farmacisti?

689. Një grua vjen në farmaci për të ekzekutuar recetën e marrë tek mjeku. Në recetë mjeku kishte përshkruar ciprofloksacinë 500 mg, 2 herë në ditë, vitaminë C 500 mg, 2 herë në ditë, buskopan 10 mg, 3 herë në ditë. Pacientja referon se ka harruar ti tregojë mjekut se ka një vonesë të ciklit menstrual. Si do të veproni në këtë rast?
690. Një pacient drejtohet pranë farmacisë për të marrë një shurup pasi ka kollë të thatë. Pacienti referon se vuan dhe nga smundja e diabetit dhe trajtohet me barna. Çfarë kujdesi duhet të bëjë farmacisti në këtë rast?
691. Pranë jush vjen për tu ekzekutuar një recetë e cila në përmbajtje ka: Solucion fiziologjik, solucion rhinger, solucion methronidazole. Çfarë informacioni duhet të kërkojë farmacisti para ekzekutimit të recetës dhe çfarë rekomandimi duhet t'i japi ai?
692. Në farmaci një qytetare kërkon të marrë një kontraceptiv urgjence. Si do veproni?
693. Një qytetar që vjen në farmacinë ku ju punoni ndonëse ju sheh me uniformën e punës nuk është i bindur që ju jeni farmacist dhe refuzon që ju ti ofroni shërbim farmaceutik. Si do të mundeni ju ta sqaroni këtë situatë?
694. Një pacient i cili ka marrë mjekim në farmacinë tuaj, drejtohet pranë jush i shqetësuar pasi gjatë përdorimit të barnave ai ka shqetësime gastrointestinale dhe ajo që e kishte trembur më shumë ishte ngjyra e zezë e feçes. Ju nuk iu kujtohet pacienti si rast që i keni dhënë mjekim. Si do veproni për të sqaruar situatën?
695. Sa është kompetenca e farmacistit për të trajtuar mykun në thua?
696. Pranë farmacisë paraqet një i moshuar i cili referon se është me tension të ulët por ka shtrëngime në kraharor. Mendoni se pacienti duhet të qetësojë dhimbjen me nitroglicerinë? Argumento.
697. Në farmaci një qytetare referon se ka rrënie flokësh, çarje të cepave të buzëve dhe thyerje thonjsh. Çfarë do mendoni për këtë rast dhe çfarë do i rekomandoni qytetares?
698. Një pacient vjen pranë jush dhe ka një recetë në të cilën përshkruhet hekur, vitaminë B6 dhe vitaminë C. Çfarë problemi mendoni se ka pacienti? Përse është i nevojshëm ky kombinim? Çfarë rekomandimesh do i jepni pacientit gjatë përdorimit?
699. Përse një fëmije kur ka temperaturë të lartë mjeku i shoqëron terapinë për uljen e temperaturës dhe me diazepam.
700. Në farmaci një pacient që vuan nga probleme hepatike vjen për të ekzekutuar një recetë të marrë te mjeku ku ndër të tjera ka të përshkruar dhe barin luminal. Përse mendoni se ky bar gjendet i përshkruar në një recetë që trajton një problem hepatic? Në cilin grup farmakologjik futet luminali dhe cili është emri xhenerik i tij?
701. Në një recetë që ka të përshkruar barin haloperidol gjendet i përshkruar dhe bari parkopan 5 mg. Pse mendoni se është bërë një kombinim i tillë?

Kapitulli V

Farmakognozi

Literatura e rekomanduar

- *Farmakognozia për studentët e farmacisë,*

702. Cili është përkufizimi për drogën mjekësore dhe bimën mjekësore?
703. Ç'është Fitoterapia?
704. Përmendni disa forma të Mjekësisë Alternative e Komplementare.

705. Cilët janë format e përdorimit (apo të përgatitjes për përdorim nga pacienti) të çajrave mjekësorë dhe ku bazohet përzgjedhja e secilës prej tyre?
706. A mund të bashkëmerren (të merren në të njëjtën kohë) barnat e sintezës dhe përgatesat bimore?
707. Përmendni shembuj të ndërveprimeve të barnave të sintezës me drogat bimore (përgatesat e tyre).
708. Përse përdoren bishtat e thara të frutave të vishnjeve dhe qershive, *Petiolum Cerasorum* (sin. *Stipites Cerasorum*)?
709. Cilat nga drogat e mëposhtme kanë efekt diuretik dhe mund përzihen së bashku për përgatitjen e specieve bimore (çajrave bimore) diuretike:
Folium Betulae, Cortex Chinae, Fructus Juniperi, Fructus Hyppocastani, Folium Stramoni, Rhizoma Graminis, Sigma Maydis.
710. Cili është përdorimi terapeutik i *Folium Uvae ursi* (gjethe e gërdecit apo rrush arushe) dhe në ç'forma farmaceutike përdoret?
711. Cilët janë përbërësit kimik të *Folium Uvae ursi* me efekt antiseptik të rrugëve urinare?
712. A mund të aplikohet në doza të larta si dhe për kohë të gjatë (më shumë se 5 ditë, gjithashtu disa herë gjatë vitit) trajtimi me *Folium Uvae ursi*?
713. Në cilat raste kundërrindikohet përdorimi i *Uva ursi* ?
714. Cilët janë përdorimet terapeutike të *Herba Polygoni avicularis* (Bar Pate)?
715. Cilët janë përdorimet terapeutike të *Fructus Juniperi communis* (frute të Dëllinjës së zezë)?
716. A mund të përdoret *Fructus Juniperi* në të sëmuret me veshka apo në gratë shtatzane?
717. Çfarë efekti ushtrojnë farat e Sinapit të zi (*Semen Sinapis nigrae*)?
718. Në cilat patologji këshillohet përdorimi i përgatesave me ekstrakt të *Cortex* dhe/apo *Semen Hippocastani* dhe cilat grupe kimike përbërëse të tyre janë bartëse të efekteve terapeutike.
719. Për çfarë këshillohet të përdoret *Folium (Herba) Melissa* (Bar I Milcës apo Bar bleta)?
720. Për çfarë përdoret *Herba Centauri* (Bar Kinëfushe) dhe në ç'forma galenike përdoret droga.
721. Cilat janë efektet (veprimet) farmakologjike dhe përdorimet mjekësore të ekstrakteve të *Radix Echinaceae*?
722. Cilat janë përdorimet terapeutike të *Folium Cynarae* (Gjethe e Angjinares) dhe në ç'forma farmaceutike përdoret?
723. Përse përdoret ekstrakti i *Fructus Silybi mariani* (frute Gjembgomari)?
724. Cilët janë principet aktive bartëse të efekteve hepatoprotektore të ekstraktit të Gjembgomarit?
725. Përse përdoret *Fructus Cynosbati* (frute të Trëndafilin të egër) dhe në ç'formë këshillohet të përgatitet çaji me frutet e Trëndafilin të egër?
726. Cilët janë përdorimet mjekësore të *Herba Saturea* (Bar Trumze)?
727. Cilët janë veprimet farmakologjike të *Fructus Myrtilli* (frute të boronicës) dhe cilët janë principet aktive përgjegjëse për këto efekte?
728. Cili është veprimi i gjetheve dhe kallinjve të frutifikuar të *Plantago major* (Gjethedelli i madh)?

729. Cilët janë veprimet farmakologjike dhe ku këshillohet të përdoret *Folium et Radix Cichorii* (gjethe dhe rrënjë çikoreje)?
730. Cilët janë veprimet farmakologjike dhe ku këshillohet të përdoret *Flores Helychrisi* (lule e akës)?
731. Cilat nga drogat e poshtëshënuara bëjnë pjesë në çajrat e përbëra me efekt antidiarrok (species antidiarrok): *Fructus Myrtilli*, *Fructus Ammi major*, *Cortex Quercus*, *Cortex Chinae*, *Semen Sinapis*, *Semen Ricini*, *Radix Potentillae*, *Radix Glycyrrhizae*. Cilin grup kimik të lëndëve dytësore, që ndikon në këtë efekt, kanë të përbashkët bimët antidiarroke?
732. Cilat nga drogat e poshtëshënuara kanë efekt ekspektorant dhe mund të përdoren për përgatitjen e çajrave mjekësore-specieve ekspektorante apo në formë të shurupeve (ekstrakteve) me efekt ekspektorant:
Radix Gentianae, *Radix et Rhizoma Primulae*, *Herba Thymus vulgaris*, *Herba Absinthii*, *Herba Thymus serpyllus*, *Flores Verbasci*, *Radix Glycyrrhizae*, *Folium Eucalypti*, *Folium Convallariae*.
733. Ku përdoren ekstraktet e *Herba Hypericii* (bar Lulebasani)?
734. Cilët janë veprimet (vetitë) farmakologjike dhe për çfarë përdoret *Folium et Flores Tiliae* (gjethe dhe lule Bliri)?
735. Cilët janë përdorimet terapeutike të *Folium et Flores Malvae* (Mullaga e zakonshme)?
736. Përse përdoren *Flores et Aetheroleum Lavandulae* (lule dhe esenca e Livandos)?
737. Cilët janë përdorimet e ekstraktit të rrënjëve dhe rizomave të Valerianës (*Radix et Rhizoma Valerianae*)?
738. Cilët janë veprimet farmakologjike dhe përdorimet terapeutike të *Flores et Fructus Crataegi* (lule dhe frute Murrizi)?
739. Cilët janë veprimet farmakologjike dhe përdorimet e *Flores Sambuci* (lule Shtogu)?
740. Çfarë është *Propolisi* (zami i bletëve)?
741. Përmendni disa nga grupet kimike përbërëse të *Propolisit*?
742. Cilat janë efektet farmakologjike dhe përdorimet terapeutike të *Propolisit*. Përmendni format farmaceutike të përdorimit të tij.
743. Cilët janë efektet terapeutike të infuzit me gjethet (apo barin) e Mentës (*Menthae piperitae*)?
744. Çfarë efektesh farmakologjike ka esenca e Mentës?
745. Si përftohet vaji i dafinës (*Oleum Lauri*) dhe ku këshillohet përdorimi i tij?
746. Përse përdoret ekstrakti vajor nga majat e lulëzuara të *Herba Hyperici* –bar i Lulebasanit (vaji i Lulebasanit)?
747. Në se nga kamomila dëshirojmë të marrim një efekt antinflamator ose spazmolitik, është e nevojshme të përdorim tinkturën alkoolike apo infuzionin.
748. Çfarë janë infuzionet, dekoktet dhe çajrat? Ku ndryshojnë ato. A mund të përzihet një tinkture ose ekstrakti i lëngshëm me tretësira ujore.
749. A mund të përzihen vajrat dhe vajrat esenciale në mjedise ujore.
750. Përse përdoren: kamomila (*Matricaria recutita*), Gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanus*), Angjinari (*Cynarea scolymus*), Rrushi i ariut (*Arctostaphylos uva ursi*), Dëllënja e zezë (*Juniperus communis*), rrenjë e Gramit (*Agropyron repens*), Hithra (*Urtica dioica*), Lisra (*Thymus vulgaris*), Panax ginseng, farat e Kungullit (*Cucurbita pepo*), Aloe vera, Pelini (*Artemisia absinthium*).